REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
Njësia Org. 01 Nr.Prot. 7425
Data 05.09.2019

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
***Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry***
***Kabineti i Ministrit – Kabinet Ministra – Cabinet of the Minister***

**01.Ref. Nr.55**
**Prishtinë, 05.09.2019**

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10, 11, dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), si dhe nenit 8 paragrafi 1 nënë paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 8 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive merr:

**VENDIM**

Për shfuqizimin e Vendimit të datës 16.08.2019 për ndalimin e importit të Mjaltit Natyral (0409 000 000) dhe Patates (0701 90 9000) me prejardhje nga Republika e Maqedonisë Veriore.

1. Shfuqizohet Vendimi i datës 16.08.2019, nr. 6886 për ndalimin e importit të Mjaltit Natyral (0409 000 000) dhe Patates (0701 90 9000) me prejardhje nga Republika e Maqedonisë Veriore.

2. Ky vendim merret pas dakordimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për heqjen e të gjitha barierave që pengojnë lëvizjen e lirë të mallrave dhe në veçanti pas vendimit të autoriteteve përgjegjëse të Maqedonisë së Veriut për heqjen e ndalesës për importimin e shitjes së rasadit të Peshkut nga Kosova dhe importimin e peshkut të gjallë që dedikohet për rritje ose mbushjen e hurdhave me peshq të vegjël me prejardhje nga Kosova.

3. Obigohet Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Endrit SHALA**

**Ministër**

REPUBLIKA E KOSOVËS – MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË – PRISHTINË/A

Vendimi i dërgohet:

- *Zyres së Kryeministrit;*
- *Ministrisë së Financave;*
- *Doganës së Republikës së Kosovës;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të MTI-së;*
- *Odes Ekonomike të Kosovës;*
- *Odes së Afarizmit të Kosovës;*
- *Departamentit Ligjor të MTI-së;*
- *Departamentit të Tregtisë të MTI-së;*
- *Arkivit të MTI-së.*